

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® Primer MB

PRAJMER EPOKSID PA TRETËS DHE BARRIERË LAGËSHITIE PËR NGJITJEN E DYSHEMEVE PREJ DRURI

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® Primer MB është prajmer epoksid me 2 përbërës dhe barrierë lagështie për adezivët SikaBond gjatë ngjitjes së dysHEMEVE prej druri të aplikuar mbi nënshtresa të vështira.

PËRDORIMET

Sika® Primer MB është krijuar për t'u përdorur në kombinim me adezivët për ngjitjen e dysHEMEVE prej druri SikaBond:

- Për kontroll të lagështisë mbi nënshtresat me bazë çimentoje dhe përmbajtje lagështie deri në 6 %.
- Për konsolidim të nënshtresës prej betoni, çimentoje, llaçi anhidriti dhe nënshtresave të restauruara.
- Për përmirësim të ndërkapjes të mastikut asfaltik të spërkatur dhe mbi mbetjet e vjetra të adezivëve.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Me 2 përbërës
- Epoksid reaktiv
- Pa tretës
- Aplikim i lehtë, viskozitet i ulët
- Mundëson përfundim të shpejtë
- Depërtim i mirë dhe stabilizim i nënshtresës
- I përshtatshëm për restaurim të nënshtresave ekzistuese
- I përshtatshëm për përdorim me ngrohje nën dysHEME

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	rrëshirë epokside me 2 përbërës		
Ambalazhi	Përbërësi A		kovë metalike 7.5 kg
	Përbërësi B		kovë metalike 2.5 kg
	Përbërësit A+B		kovë metalike 10.0 kg
Ngjyra	Blu		
Jetëgjatësia	Sika® Primer MB ka jetëgjatësi prej 24 muajsh nga data e prodhimit, nëse ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar dhe nëse plotësohen kushtet e magazinimit.		
Kushtet e magazinimit	Sika® Primer MB duhet të ruhet në kushte të thata, i mbrojtur nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe në temperatura midis +5°C dhe +25°C.		
Dendësia	Përbërësi A	~1.10 kg/l	(ISO 2811-1)
	Përbërësi B	~1.00 kg/l	
	Të përzierë	~1.10 kg/l	

TË DHËNA TEKNIKE

Fortësia Shore A	~80 (pas 7 ditësh)	(ISO 868)
Rezistenca ndaj ngjeshjes	~70 N/mm ² (pas 7 ditësh)	(EN 196 pjesa 1)
Rezistenca termike	Sika® Primer MB mund të ekspozohet në mënyrë të përhershme ndaj nxehtësisë së thatë ≤ +50 °C dhe në mënyrë të përkohshme ndaj nxehtësisë së thatë ≤ +80 °C. Shënim: Për të parandaluar dëmtimin e elementëve të instaluar të dyshemesë prej druri, temperatura e sipërfaqes nuk duhet të kalojë +25°C.	
Temperatura e funksionimit	-40 °C min. / +70 °C max.	

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes	Përbërësi A : Përbërësi B = 100:37 (për vëllim)	
Konsumimi	Beton dhe/ose llaç i hollë anhidriti dhe çimentoje, duke përfshirë llaçet e anhidritit të rrjedhshëm	400–600 g/m ² , në varësi të absorbueshmërisë së nënshtresës.
	Mastik asfaltik i spërkatur	250–300 g/m ²
Temperatura e mjedisit	+10 °C min. / +30 °C max., min. 3°C mbi temperaturën e pikës së vesës	
Lagështia relative e ajrit	< 80 %	
Temperatura e nënshtresës	Gjatë shtrimit dhe derisa Sika® Primer MB të jetë tharë plotësisht, temperaturat e nënshtresës dhe ambientit duhet të jenë midis +10°C dhe +30°C pa ngrohje nën dysheme dhe midis +20°C dhe +30°C me ngrohje nën dysheme.	
Lagështia e përmbajtur e nënshtresës	Përmbajtja e lejueshme e lagështisë pa ngrohje nën dysheme Për llaçe çimentoje për dyshemetë <6 % CM Për llaçe anhidriti për dyshemetë <0.5 % CM Për dysheme magnetiti 3–12 % CM (në varësi të përmbajtjes organike) Përmbajtja e lejueshme e lagështisë me ngrohje nën dysheme Për llaçe çimentoje për dyshemetë <6 % CM Për llaçe anhidriti për dyshemetë <0.3 % Për dysheme magnetiti 3–12 % CM (në varësi të përmbajtjes organike) Për të kontrolluar përmbajtjen e lagështisë, përdorni “Testi i mushamasë prej gome”, sipas ASTM. Një fletë polietileni me përmasa > 1x1 m duhet të vendoset mbi sipërfaqen e betonit. Lëreni fletën e polietilenit në vend për > 24 orë përpara testimit. Ky testim lejon detektimin e transmetimit të avujve të kondensuar. Shënim: CM: metoda e karbidit, për të përcaktuar përmbajtjen e lagështisë së nënshtresës. Për të gjitha përmbajtjet e lagështisë, cilësinë e nënshtresave dhe sipërfaqeve, ndiqni gjithnjë udhëzimet e prodhuesit të dyshemesë prej druri.	
Koha e punueshmërisë	Temperatura e ajrit të ambientit +10 °C +20 °C +30 °C	Koha e punueshmërisë ~60 min ~30 min ~15 min
	Shënim: Mos përdorni materialin e përzjerë pas kohës së punueshmërisë.	

Koha e maturimit

Kushtet

+10 °C

+20 °C

+30 °C

Koha e tharjes

~18 orë

~12 orë

~6 orë

Shënime: Shpejtësia e tharjes varet nga temperatura, lagështia relative dhe absorbueshmëria e nënshtresave. Temperatura e lartë dhe lagështia relative e ulët shkurtojnë kohën e tharjes. Materiali i tharë kthehet në transparent.

UDHËZIME APLIKIMI

Për aplikimin e Sika® Primer MB duhet të zbatohen të gjitha rregullat e pranuar për instalimin e dyshemeve prej druri.

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

- Nënshtresa duhet të jetë e pastër, e thatë, e qëndrueshme dhe homogjene, pa vaj, graso, pluhur dhe grimca të lira. Boja, korja e çimentos dhe kontaminues të tjerë duhet të hiqen.
- Të paktën 50 % e sipërfaqes duhet të pastrohet nga adezivi i mbetur (p.sh. me bluarje).
- Rekomandohet testimi paraprak i rezistencës së dyshemesë.
- Rezistenca ndaj kompresionit: > 8 N/mm²
- Rezistenca ndaj tërheqjes: > 0.8 N/mm²
- Betoni dhe/ose llaçi i dyshemesë duhet të jenë të qëndrueshëm dhe të pastruar me fshesë industriale.
- Llaçi i anhidritit, përfshirë llaçin e rrjedhshëm të anhidritit duhet të jetë i qëndrueshëm dhe i pastruar me fshesë industriale pak përpara veshjes.
- Mastiku i asfaltit duhet të spërkatet deri në ngopje dhe të pastrohet me fshesë industriale.
- Në betonin e përforcuar me fibra, çdo fibër e ekspozuar mbi sipërfaqe duhet të digjet.
- Duhet të zbatohen udhëzimet e prodhuesit të llaçit të dyshemesë.
- Për këshilla specifike rreth projektit, ju lutemi kontaktoni me shërbimin teknik Sika.

PËRZIERJA

Shtoni përbërësin B tek përbërësi A në raportin e saktë dhe përdorni mikser elektrik në shpejtësi të ulët (300–400 rpm).

Kërkohet kohë minimale përzierjeje prej 3 min.; përzierja duhet vazhduar derisa miksi të jetë homogjen. Hidhni materialin e përzierë brenda një konteineri të pastër dhe përzieri sërish.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Aplikoni Sika® Primer MB në mënyrë të njëtrajtshme (në 2 drejtime 90°) mbi nënshtresë me rul najloni, duke u siguruar se arrihet një veshje e vazhdueshme mbi të gjithë sipërfaqen (finiturë si pasqyrë).

Aplikimi	Veshjet	Rezultati
Vetëm barrierë lagështie	Min.1 x	Si pasqyrë
Vetëm konsolidim nënshtrese	Min. 1 x	Depërtim i mirë
Vetëm përmirësim ndërkapjeje	Min. 1 x	Si pasqyrë
Barrierë lagështie + konsolidim nënshtrese	Min. 2 x	Si pasqyrë
Barrierë lagështie + përmirësim ndërkapjeje	Min. 2 x	Si pasqyrë

Duhet të ruhet një kohë pritjeje prej > 8 orësh dhe < 36 orësh midis shtresave të Sika® Primer MB.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit menjëherë pas përdorimit. Pas tharjes, materiali i mbetur mund të hiqet vetëm mekanikisht.

DOKUMENTA SHITESË

- Fleta e të dhënave të sigurisë
- Tabela e trajtimit paraprak për izolimin & ngjitjen

KUFIZIME

- Nëse Sika® Primer MB është lënë jashtë për më tepër se 36 orë, sipërfaqja duhet të pastrohet me një leckë për pastrimin e lagështisë dhe të kontrollohet për defekte përpara vazhimit me mbiveshjen.
- Mos aplikoni Sika® Primer MB mbi nënshtresa nën presion të lartë avujsh.
- Sika® Primer MB i freskët duhet të mbrohet nga lagështia, kondensimi dhe uji për > 24 orë.
- Shmangni mbledhjen e pellgut me ujë mbi sipërfaqen e Sika® Primer MB.
- Kur përdoret në kombinim me adevivë të tjerë SikaBond® për ngjitjen e dyshemeve të drurit, Sika® Primer MB nuk duhet të spërkatet me rërë. Sika® Primer MB rekomandohet për përdorim me të gjithë adevivët SikaBond® prej poliuretani dhe hibridë për dyshemetë e drurit.
- Nëse Sika® Level-200 / -300 / -300 extra / -315F ose -340 vijon pas shtresës së Sika® Primer MB në strukturën e sistemit, shtresa e dytë e Sika® Primer MB duhet të spërkatet plotësisht me rërë kuarci (pas 15–30 minutash në +20 °C). Filloni me spërkatje të lehtë dhe pastaj deri në ngopje me rërë kuarci 0.4–0.7 mm.
- Instalimi i dyshemeve prej druri në zona pa membranë kundër lagështisë mund të kryhet vetëm me sistemin e rregullimit të lagështisë Sikafloor® EpoCem® dhe Sika® Primer MB si barrierë lagështie. Për udhëzime të detajuara kontaktoni me departamentin e shërbimit teknik.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sika® Primer MB
Mars 2019, Botimi 02.01
020512081000000001

SikaPrimerMB-sq-AL-(03-2019)-2-1.pdf

